



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE**  
**QENDRA SPITALORE “XHAFERR KONGOLI” ELBASAN**

**Date 29.03.2023**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pajisje mjeksore per sherbimin ORL”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pajisje  
mjekesore 33100000-1**

**Fondi limit/ Vlera e pritshme e kontratave është 5,422,299 (pesemilion e katerqind e njezet  
e dymije e dyqind e nentedhjete nente ),leke pa Tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Qendra Spitalore Xhaferr Kongoli Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë

## I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos me mbeshtetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në të cilën është e përcaktuar se: "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla."

### b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", në të cilën është e parashikuar se:

*Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*

## 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

*Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit .....

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Xhiroja vjetore minimale e të paktën njërit prej tre viteve të fundit financiare të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të fondit **limit të kontratës**.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/b dhe pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

*b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.*

Neni 43 pika 4

*Nese vleresohet ,autoriteti kontraktor mund te kerkoje qe operatoret ekonmik te japin informacione ne bilancet e tyre vjetore ,per nje periudhe maksimumi 3 ( tre ) vitet e fundit financiare qe tregojne raportet ndermjet aktivitet dhe pasivitet. Kjo kerkese quhet e permbushur nese ne dy bilance te njepasnjeshme nuk ka raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet.*

---

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave

**2.2.2** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar për vitin 2022 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632,

datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

**2.2.3** Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

*Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

**Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).**

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës limit të kësaj kontrate

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe/ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

***Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore, në përputhje me parashikimet e nenit 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021***

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ne të cilen gjejmë të përcaktuar se : pika 4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësia. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me pikën 4 të nenit 40 ne të cilën është përcaktuar: pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ne të cilën është përcaktuar: pika 4 *Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për aftësinë e tyre teknike nepermjet përvojave të duhura që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit për zbatimin e kontratës. Për këtë është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.**

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Ne bazë të VKM-se nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, pika 4/b ku citohet se: “Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një

*vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”*

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të vetedeklaroje origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese (te plotësohet në shtojcën 1 të DST)

**Argumentimi:** (Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. në të cilën është përcaktuar: Pika 8 ” *Autoriteti/enti kontraktor ,pervec kerkesave te parashikuara ne kete nen ,mund te percaktoje kriteret e vecanta ne varesi te objektit qe prokurohet ,te cilat i vlereson te nevojshme per ekzekutimin me sukses te kontrates ” dhe keto kerkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi).*

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/broshurë me të dhënat teknike për pajisjen e ofruar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për këto artikull. **Në katalogë, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme ,sipas modelit të deklaruar.** (Katalogu duhet të ngarkohet në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe në pjesët që kanë lidhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST).

**Argumentimi:** *Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vertetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 date 19.05.2021*“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. **ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:**

*b) fotografitë apo katalogët teknike; dhe/ose ;*

2.3.2 Deklarate për përmbushjen e afatit të garancisë (1 vit garanci, duke përfshirë blerjen dhe zëvendësimin e pjesëve të difektuara me pjesë këmbimi të reja dhe origjinale, si dhe të gjitha shërbimet periodike parandaluese që parashikon prodhuesi brenda periudhës së garancisë).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku shprehet rrjedhimisht se *Autoriteti Kontraktor mund të hartojë kriteret në përputhje dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si dhe pika 8 e po këtij neni në të cilën është përcaktuar : Pika 8. Autoriteti/enti kontraktor ,pervec kerkesave te parashikuara ne kete nen ,mund te percaktoje*

*kritere te vecanta ne varesi te objektit qe prokurohet ,te cilat i vlereson te nevojshme per ekzekutimin me sukses te kontrates*

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te paraqese nje Vetëdeklaratë, që pajisja e ofruar është e re, të një prodhimi original

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku shprehet rrjedhimisht se *Autoriteti Kontraktor mund te hartoje kritere ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates, si dhe pika 8 e po ketij neni ne te cilen eshte percaktuar : Pika 8. Autoriteti/enti kontraktor ,pervec kerkesave te parashikuara ne kete nen ,mund te percaktoje kritere te vecanta ne varesi te objektit qe prokurohet ,te cilat i vlereson te nevojshme per ekzekutimin me sukses te kontrates*

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqese autorizim nga kompania prodhuese ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për pajisjen e ofruar ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin për ofertim te pajisjes objekt i kësaj procedure .Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si telefon,faks,e-mail,ëbsite nevojshme për Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku eshte e cituar: Pika 5. *”Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/entikontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Autorizimi per OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet nga ana e njësisë së prokurimit si e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

**Argumentimi:** Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 77 te Ligjin nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik", ne te cilen gjejme te percaktuar se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore percaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Gjithashtu ky kriter eshte bazuar dhe ne nenin 21, 22 dhe 23 te Ligjit Nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekesore".*

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te paraqesi Certifikatën **ISO 9001:2015** mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësise" ose **EN ISO 13485:2012/EN ISO 13485:2016** mbi "Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekesore ose ekuivalente, të prodhuesit, në përputhje me objektin e prokurimit. ose në rastin kur OE ofertues nuk është prodhues të paraqesë **Vetëdeklarim ku të deklarojë se furnizuesi është konform Standardeve të Cilësisë.**

*Vetëdeklarimi do të verifikohet në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, dhe në rastin e shpalljes fitues, OE do të dorëzojë Certifikatën në fjalë.*

Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse brenda afatit të vlefshmërisë. *Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme është percaktuar duke u bazuar në piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020 "Per Prokurimin Publik", ne te cilen gjejme te percaktuar se:

*1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

Si dhe ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik"ku percaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, ia kredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autodeklaratë për pajisjet mjekësore ofertuesi (distributori/prodhuesi ) për konformitetin **FDA** ose për konformitetin me normat **MDD 93/42/ EEC** ose **98/79 EC**, ose **MDR 2017/745** (Regulation (EU) 2017/745 On Medical Devices) ose **ekuivalente** dhe bashkelidhur me kopjet të certifikatave përkatëse **CE/DC**



**(Deklarate konformiteti)**, origjinale, ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar duke u bazuar në piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 "Per Prokurimin Publik", në të cilën gjejmë të përcaktuara se:

*1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ I vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar I akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

Si dhe në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku përcaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ I vlerësimit të konformitetit, ia kredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

**2.3.8 2.3.10.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për pajisjen e kërkuar në formë të tabelave, ku të plotësohet: Specifikimet teknike të ofruara, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut të artikullit/produktit, Numri i faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerrë nga katalogu i prodhuesit, si dhe certifikimet përkatëse për produktin.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me **piken 1 të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik"**, në të cilën është përcaktuar se:

*1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohen.*

*Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.*

*Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë I nevojshëm transferimi I të drejtave të pronësisë intelektuale.*

*Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësitë kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

Gjithashtu ky kriter është në përputhje me piken 2 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ku përcaktohet se: *Pika 2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të*

*përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, nëpërputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që I vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.*

Autoriteti Kontraktor nepermjet ofertes teknike, do te bej te mundur verifikimin me te sakte te artikullit te ofertuar, specifikimeve te tij, origjina, konformiteti etj me dokumentacionin mbeshtetes te paraqitur nga ofertuesi.

## **II- ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

#### **1. Specifikimet teknike për secilën aparaturë janë :**

##### **1. DRITE MJEKU LED**

- Llampë portative për në kokë, për mikrokirurgji me performancë dhe cilësi të lartë.
- Duhet te ketë të rregullueshme madhësinë e pikës nga mini grila e brendshme e dritës
- Të ketë imazhe të sakta të dritës me lente optike
- Të ketë dizajn të integruar pa tela
- Të furnizohet me bateri dhe karikues baterie
- Jastëkët të jenë lëkure higjienike dhe komode
- Gjerësia e shiritit të kokës të jetë e rregullueshme
- Të ketë celës ndezës/fik, kontroll të ndriçimit dhe LED të statusit të baterisë në ndarjen e baterisë
- Burimi i ndriçimit: LED 5W
- Intensiteti i ndriçimit: 10-40,000 lux
- Temperatura e ngjyrës: 6000K
- Madhësia e pikës: Maksimumi 70 mm, Minimumi 50 mm në 32 cm
- Minimumi i jetëgjatësisë së llambës jo me pak se 50,000 orë
- Koha e funksionimit të baterisë deri 5-12 orë
- Koha e karikimit të baterisë deri 4 orë
- Pesha jo me shumë 200 g

##### **2. ASPIRATOR KIRURGJIKAL ORL**

- Te jete I pershtatshem per aspirimin gjate procedurave te ORL
- Te jete me fuqi te larte dhe me piston per nje funksion te qete
- Te jete me pompe per nje rrjedhje ajri deri ne 40 litra /min
- Te jete me rregullues vakumi : 0÷ -0.85 bar (0÷ -85 kPa)
- Te jete e pajisur me shishe te autoklavueshme 1000 cc me valve mbrojtese
- Te jete e pajisur me 99% Antibacterial hydrophobic filter
- Te jete e pajisur me Setin e tubave te sterilizueshem

### 3. AUDIOMETER DIAGNOSTIK

- Audiometer professional per me pershkrueshmeri te tingullit ne ajer, kocke dhe masking
- Te jete me 2 kanale dixhitale per matjen e tonaliteteve te ndryshme
- Me ekran me ngjyra e me prekje LCD minimum 4.3 inch
- Pershkueshmeria e ajrit te jete:125-8000hz
- Te kete mikrofon dhe atoparlant te integruar si dhe nepermjet kufjeve e mikrofonit te jashtem
- Te kete pulsantin e pergjigjes se pacientit
- Te jete e pajisur me printer termal te integruar.
- Me dalje usb per lidhje direkte me kompjuterin me software per nje analize te plote
- Te kete memorje te pakten 100 GB s I dhe te pakten 100 paciente, qofte AC dhe BC
- Pershkueshmeria e ajrit e tipit TDH-39 / DD45 kufje te jashtme headphones, ER 3 / IP30 kufje te brendshme
- Pershkueshmeria e Kockes e tipit B-71 me fushe te lire
- Te kete sinjalet si me poshte:
- Stimuli: ton i pastër, ton i ftohtë
- 2 hyrje të jashtme për audiometrin e të folurit
- Hyrje e MIC për audiometrin e të folurit live
- Hyrje e brendshme (flash memory) për audiometrinë e të folurit (Harp Plus vetëm)
- Maskimi: NBN, WN, SN
- Hapi attenuator: 1 dhe 5 dB
- Paraqitja: E vazhdueshme, e pulsuar (0.5, 1 dhe 2 Hz)
- Ndryshues: 5 Hz sinjal modulues i valës
- Te mundesoje testimet si me poshte:  
Audiometria e tonit të pastër

Prag auto (Hughson-Westlake i modifikuar)

Audiometria e të folurit (2 kanale)

ABLB

SISI: rezultati automatik; 1 dB rritje (5 dB për familjarizim)

Stenger, me ton të pastër ose stimulim të të folurit

Prishja e tonit, me kohëzgjatje 60 ose 120 sek.

DLI, me rritje midis 0 dhe 5 dB

2 kanale të pavarura Master dëgjim

Testi TEN

Testi QuickSIN®

- Te jete e pajisur me aksesoret e meposhtem:  
Kufje supra-aurale TDH-39 ose DD45  
  
B71 vibrator kockash  
  
pulsanti i reagimit të pacientit  
  
Kufjet me mikrofon bumi  
  
Mikrofon me klip për komunikim pacient-operator  
  
Kablllo lidhëse USB

#### **4. TIMPANOMETER DIAGNOSTIK**

- Timpanometer professional per diagnostimet ne frekuencat 226 Hz dhe mundesimin deri ne 1000 Hz ne nivelet 85 Db me diapason te volumit 0.2 ÷ 8.0 ml (@ 226 Hz)
- Te mundesoje stimulimet e nivele nga 250-8000 Hz ne nivelet 95-120 Db
- Te jete I pajisur me systemin e presionit me pompe rrotulluese me rrjedhje te pandreprete si dhe te mundesoje rregullimet manual te presionit si per timpanometrine ashtu dhe per testet e refleksit
- Te mundesoje testimet si me poshte:
  - Tympanometri (automatike) dhe manuale
  - Pragu i refleksit akustik (automatik)
  - 2 Sekuenca automatike të testimit (tympanometry + test refleks)
  - Pragu i refleksit akustik (manual)
  - Prishja e reflekseve akustike
  - Funksioni i Tubave Eustachian (TM i paprekur dhe i perforuar)
- TIMPANOMETRIA
  - Modaliteti: absolut ose i kompensuar
  - Skanim i vetëm
  - Gama e zgjedhur e presionit të përdoruesit
  - Gama maksimale: -600 deri në +400 daPa
  - Kufijtë e sigurisë: -800 daPa dhe +600 daPa

Vlerat në dispozicion: 50, 100, 200, 300 daPa/sec dhe AUTO (100-300 daPa/sec)

Rregullim i presionit manual

Mundesia e fillimit në auto

- **PROVA E REFLEKSEVE AKUSTIKE**  
Stimulim ipsilateral dhe kontralateral  
  
Stimulim jo akustik  
  
Stimuli ON-Time: i zgjedhshëm nga 0.5 në 2.5s  
  
Stimuli OFF-Time: i zgjedhshëm nga 0.5 në 2.5s  
  
Katër teste të ndryshme në dispozicion:  
  
Prag automatik  
  
Intensitetet i fiksuar  
  
Rritje e intensitetit  
  
Modaliteti manual
- **TESTI I ULJES SË REFLEKSEVE AKUSTIKE**  
Stimulim ipsilateral dhe kontralateral  
  
Stimulim jo akustik  
  
Kohëzgjatja e testit: 10 sek ose 20 sek (e zgjedhur)
- **TEST I FUNKSIONIT TË TUBIT EUSTACHIAN**  
ETF me TM të paprekur: Testi Williams  
  
ETF me TM perforuar: Test Toynbee, me kohëzgjatje të personalizuar dhe  
gama e presionit
- **TESTET TË SHPEJTA**  
Te kete në dispozicion dy teste të shpejta të programueshme nga përdoruesi  
  
Çdo test përbëhet nga një sekuençë prej  
  
Timpanometri dhe Test refleks (Me intensitetet fiks ose prag automatik, me  
përdoruesin me parametrat e përcaktuar)
- Te jete e pajisur me aksesoret e meposhtem:  
Kutia e kontrollit me sonda

Rrip shpatullës për kutinë e kontrollit të sondave

Rrip dore për kutinë e kontrollit të sondave

TDH-39 kufje kontralatrale ose DD45 ose kufje kontralatrale

Kavitete e kalibrimit

Kutia e tapave të veshëve

Kabllo lidhëse USB

Manuali i përdoruesit

## **5. SHTRAT OPERACIONI ORL**

- Shtrat operator elektrik me minimum 3 ndarje mbeshtetese shpine, trupi dhe kembet
- Te kryeje elektrikisht levizjet e lartesisë, shpines, trendelenburgut , trendeleburg revers, anesore dhe rreshqitese.
- Te kryeje mekanikisht levizjet e kokës, kembëve lart poshte dhe majtas djathtas, bllokimi qendror.
- Permasat minimale 2100 mm gjatesi 600mm gjeresi.
- Lartesia ne diapazonin 800 mm deri 1200 mm
- Te kete kapacitetin deri ne 280 kg
- Trupi te jete material Celiku inoksidabel me rrota per levizje te nevojshme  
Diapazoni i lëvizjeve

•Rrëshqitje : 300mm

•Lëvizja Tilt Lateral : +20° / -20°

•Lëvizja e prapme e pushimit : +90° / -40°

•Trendelenburg : +25°

•Reverse Trendelenburg : -25°

•Pushimi i këmbës lart / Poshtë : +65° / -90°

•Lëvizja Paralele e Pushimit të Këmbëve : 80°

•Lëvizja e prehjes së kokës: +30° / -60°

•Pozicioni i kirurgjisë së veshkave : 250°

•Reverse Trendelenburg : -25°

•Flex / Pozicioni Refleks : +220° / -90°

- I pajisur me pult per rregullimin e funksioneve elektrike
- Te jete e pajisur me bateri te brendshme me zgjatje per te pakten 6 ore.
- Te jete i pajisur me alarm zanor per paralajmerrm ne rast problemi elektrik
- Te jete i pajisur me buton emergjence per ndalim te menjehershem ne rasty urgjence mjekesore

## **6. LLAMPE OPERATORE ORL**

- Llampë Operatore LED per sallën kirurgjikale me performancë dhe cilësi të lartë.
- Te jete e levizshme me bateri per nje efikasitet dhe perdorim ne salla te ndryshme
- Te jet e pajisur me minimum 28 module led per nje ndricim uniform te fushes operatore
- Te kete diametrin minimum 440 mm
- Burimi i ndriçimit: LED
- Intensiteti i ndriçimit ne distancen 1 m : 110.000 -120,000 lux
- Temperatura e ngjyrës: 3500-5000 K
- Rregullues I fokusit : 120-200 cm dhe thellesia e ndricimit 100 cm
- Rregullimi I ndricimit 1-100%
- Rrritja e temperatures ne fushen kirurgjikale jo me shume se 0.5 Grade
- Levizja e kokes se llampes ne diapazonin 0-200 grade
- Minimumi I jetëgjatësisë së llambës jo me pak se 50,000 orë

Koha e funksionimit të baterisë me 100% te fuqise deri 2 orë

## **7. TERMOCAUTER BIPOLAR**

- Pajisje elektrokirurgjike me frekuencë të lartë të përshtatshme për precizion mono dhe bipolar kirurgji dhe mikrokirurgji, pa ndryshime indore.
- Aparatura profesionale te mund te perdoret ne kirurgji te ndryshme si ORL, Urologji, Gastro, Gjinekologji, Kirurgji vaskulare etj
- Te jete e afte te të furnizojë gjithashtu fuqi operative HF për një kohë të programueshme 0.01 sek
- Te performoje CUT të pastër, BLEND me prerje koaguluese, prerje me prodhim të reduktuar të eschar te rritur, koagulim sipërfaqësor koagulim i detyruar, koagulim i thellë nëmungese nekroze koagulim i bute, prerje bipolare, Koagulim dhe mbyllje, fluguration
- Te jete e pajisur me mikrokontrollues, per nje siguri dhe kontroll absolut te fuqise, kushteve te punes dhe funksionit
- Te jete e pajisur me elektroda neutrale dhe kontrolli i sigurisë së pacientit/pllakës te monitorohet vazhdimisht.

- Te mundesoje e funksione të daljes dhe kontrollit të shpërndarjes së fuqisë dalëse, me anë të dorezës, e cila te lejoje që të kryehet operacioni duke shmangur kirurgun të heqë sytë nga fusha operative.
- Te jete pajisur me software te zhvilluar për të ofruar një përvojë pune të thjeshtë, funksionale dhe intuitive.
- Te jete meekran me prekje qe te mund te , mund të personalizojë cilësimet e punës, të ndryshoni prerjen ose fuqinë e koagulimit dhe menaxhimin e çdo funksioni të pajisjes.

- Te mundesoje funksionin sipas specifikimeve te meposhtme  
Fuqia maksimale:

PRERJE E PASTËR: 200 W - 300 Ohm

PËRZIERJA: 150 W - 300 Ohm

I PËRMIRËSUAR: 150 W - 300 Ohm

KOAGU I DETYRUAR: 150 W - 200 Ohm

KOAGU I BUTË: 100 W - 200 Ohm

FULGURATION: 100 W - 1000 Ohm

MBYLLJA BIPOLARE: 200 W - 50 Ohm

KOAGU BIPOLAR: 120 W - 50 Ohm

PRERJE BIPOLARE: 120 W - 50 Ohm

Pulsi i fuqisë RF: koha e emetimit 10 ms - 30 sek, intervali: 1 - 30

Frekuenca e punës: 360 KHz

Kontrollet: Monitorimi i qarkut të pacientit/pllakës, Monitorimi i fuqisë në dalje, kontrolli i vetëkontrollit

- Te lete e pajisur me aksesoret e meposhtem

Pllakë neutrale çeliku/gome Flex me kablllo

Kompleti 10 elektroda bipolare standarde të shkurtra Ø 2,4 mm

Kablllo rryme min 5 m

Mbajtëse për dorezë dhe elektroda



Elektrode e ripërdorshme

Pedal këmbësh i papërshkueshëm nga uji

## **8. SISTEM /IRRIGIM/ASPIRIM E VESHIT ME SENSOR**

- Sistem për larjen, irrigim/aspirim të veshit
- Të jetë e montueshme direkt në lavamanin e dedikuar
- Të jetë e pajisur me sensor të temperaturës për të treguar nëse arin 90Grade
- Të jetë e pajisur me rregullator fluksi për një rrjedhje uniforme të ujit
- Të ketë rrjedhjen e ujit 7.5 l/min
- Të ketë presionin e ujit 40–100 Psi (275 kPa–690 kPa)
- Të ketë presionin e ujit prej veshit 10–13 Psi (69 kPa–90 kPa)

## **9. SHIRINGA LAVAZHI**

- Të jetë prej metali dhe xhami me një kapacitet min 100ml.
- E pajisur me të pakten 2 kanjula .
- Të ketë përshkallezim 100 cc - 14 x Ø 4.7 cm
- Të jetë e pajisur me 2 kanjula Konike dhe ovale

## **10. SPECULUME HUNDE**

- Material i sterilizueshëm çelik inoksidant tipologjia Killian/Hartmann
- Të ketë permasat 14/50 cm.

## **11. SPECULUME VESHI**

- Material i sterilizueshëm çelik inoksidant tipologjia Hartmann
- Të ketë diametrat 4-6 mm.

## **12. KANJULE NAZALE**

- Material i sterilizueshëm çelik inoksidant tipologjia Rosen
- Të ketë permasat Ø 4 mm (18 cm).
- Të jetë e pajisur me guiden metalike të brendshme

## **13. KANJULE VESHI**

- Material i sterilizueshëm çelik inoksidant tipologjia Rosen
- Të ketë permasat Ø 3 mm (16.1 cm)
- Të jetë e pajisur me adaptor tip luer dhe valvul për gishtin

#### **14. PASQYRE LARINGU**

- Te kete diametrin ne diapazonin 10-24 mm.
- Me doreze metalike te drejte min 13 cm

#### **15. SPATULA METALIKE**

- Spatul gjuhe celik inoksidant tipologjia Mayo- 17 cm

#### **16. GERSHERE VESHI**

- Te kete permasat 6-8 cm.
- Te kete majen prerese minimum 4 mm

#### **17. PINCA BAJONETE**

- Te jete tipologjia Lucae me permasat 14 cm
- Material I sterilizueshem celik inoksidant

#### **18. LLAMPE EGZAMINIMI**

- Llampë Egzaminimi LED per mikrokirurgji dhe egzaminime me performancë dhe cilësi të lartë.
- Te jete e levizshme per nje efikasitet dhe perdorim ne salla te ndryshme
- Te jet e pajisur me minimum 8 module led per nje ndricim uniform te fushes operate
- Te kete diametrin minimum 100 mm
- Burimi i ndricimit: LED
- Intensiteti i ndricimit ne distancen 1 m : 25.000-30,000 lux
- Temperatura e ngjyrës: 6500 K
- Thellesia e ndricimit 100 cm
- Rregullimi I ndricimit 1-100%
- Jetegjatesia e llampes jo me pak se 50.000 ore pune

#### **Shenim per te gjitha aparaturat**

- Aparaturat të shoqërohen me manualet e përdorimit (Gjuha Shqip ose Anglisht)
- Aparaturat te jene te pershtatshme per rrjetin elektrik 220v/50Hz
- Aparaturat te jene te markuara me etiketen CE dhe te dhenat teknike respektive.

**Argumentimi per specifikimet teknike** : Keto specifikime jane vendosur ne baze te procesverablit date 22.02.2023“per hartimin e domosdoshmerise dhe specifikimeve teknike “ nga Komisioni i hartimit te specifikimeve teknike si dhe ne perputhje me nenin 4 pika 38/b, te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, ne piken 2 te nenit 40 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“

### FORMULARI I SASISE DHE GRAFIKU I LEVRIMIT

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Afati I Levrimnit
1	Drite mjeku LED	cope	4	60 dite nga lidhja e kontrates
2	Aspirator kirurgjikal ORL	cope	2	60 dite nga lidhja e kontrates
3	Audiometer diagnostik	cope	1	60 dite nga lidhja e kontrates
4	Timpanometer diagnostik	cope	1	60 dite nga lidhja e kontrates
5	Shtrat operacioni ORL	cope	1	60 dite nga lidhja e kontrates
6	Llampe operatore ORL	cope	1	60 dite nga lidhja e kontrates
7	Termocauter bipolar	cope	1	60 dite nga lidhja e kontrates
8	Sistem irrigim aspirim veshi me sensor	cope	1	60 dite nga lidhja e kontrates
9	Shiringa lavazhi 100ml	cope	5	60 dite nga lidhja e kontrates
10	Spekulum hunde	cope	10	60 dite nga lidhja e kontrates
11	Spekulum veshi	cope	10	60 dite nga lidhja e kontrates
12	Kanjula nazale	cope	10	60 dite nga lidhja e kontrates

13	Kanjula veshi	cope	10	60 dite nga lidhja e kontrates
14	Pasqyre laringu	cope	10	60 dite nga lidhja e kontrates
15	Spatula metalike	cope	10	60 dite nga lidhja e kontrates
16	Gershere veshi	cope	10	60 dite nga lidhja e kontrates
17	Pinca bajonete	cope	10	60 dite nga lidhja e kontrates
18	Llampe egzaminimi	cope	1	60 dite nga lidhja e kontrates

Afatet e levrimit : Njësia referuar relacionit të përlogaritjes së fondit limit përcaktoi kohëzgjatjen si më poshtë :

**Afati i kontrates eshte 60 (gjashtedhete ) dite kalendarike pas lidhjes se kontrates.**

**Sasia dhe Grafiku I levrimit** : jane vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 40 te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se: *1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e levrimit të mallrave.*

Në lidhje me kushtet e veçanta për kualifikim, njësia bazuar në rregullat e prokurimit publik të referueshme, në raport me shumën dhe shërbimin e kërkuar përcaktoi këto kritere si minimumin e kërkuar për t’u plotësuar nga operatorët ekonomikë.

Njesia e prokurimit, referuar nenit 49 pika 3 të ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 përcaktoi afatet e dorëzimit dhe hapjes të ofertave si me poshtë :

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje apo hapjen e tyre :  
11.04.2023 Ora: 10:00 [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)**